



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 37
Prishtinë, më 11 nëntor 2016, në orën 09:30
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Bali Muharremaj, Synavere Rysha, Naim Fetahu dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Enver Hoti.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Pjesëmarrësit tjerë në takim: Bujar Sejdiu, Emine Fazliu dhe Zuk Zuka, ZKA; Memli Krasniqi, Kapllan Halimi, MBPZHR; Kaltrina Zymberi dhe Hasan Hoti, Ekonomia Online; Fjolla Uka, Agnesa Haxhiu, KDI; Ferat Shala, Arben Çitaku, Luan Sabedinaj, Murat Meha, Ilir Morina, MMPH; Idriz Blakaj, Adnan Elshani, AMKMK.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015;
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015;
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015;
6. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Kryetari, theksoi se KMFP ka vendosur ta shqyrtojë Raportin e auditimit për Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015. Opinionin i auditimit, për këtë raport, është i pamodifikuar, me theksim të çështjes, pagesa të dyfishta ndaj përfituesve dhe kontrole joefektive në shqyrtimin e aplikacioneve të fermerëve dhe investimet kapitale, të bëra nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), në prona (pyje) të ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e AKP-së dhe regjistrimi i tyre si pasuri të ministrisë. Me këtë hapi diskutimin.

Ali Sadriu, filloi diskutimin, duke theksuar se opinionin i auditimit për PVF-të e MBPZHR-së, për vitin 2015, është opinion i pamodifikuar, me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes ka të bëjë me: pagesa të dyfishta ndaj përfituesve dhe kontrole joefektive në shqyrtimin e aplikacioneve të fermerëve; investimet kapitale të bëra nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), në prona (pyje) të ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e AKP-së dhe regjistrimi i tyre si pasuri e ministrisë. Raporti i auditimit për PVF-të e MBPZHR-së, të vitit 2014, ka rezultuar me 15 rekomandime kryesore, 8 rekomandime ishin adresuar, 6 në proces të adresimit dhe 1 rekomandim nuk ishte adresuar. Ministria kishte përgatitur një plan veprimi, ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, si pjesë e auditimit, ZKA-ja ka shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit, në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara, auditori ka gjetur: 1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut për vitin 2015 nuk janë bërë, megjithatë në vitin 2016 janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.2; Struktura organizative nuk është e përshtatshme për karakterin e aktivitetit të ministrisë, pasi është obliguar të rrisë numrin e stafit me kontratë për shërbime të veçanta për 70 nëpunës, për shkak të volumit të punëve dhe kapacitetit jo të mjaftueshëm të stafit.

Po ashtu, përmendi çështjen e pyjeve, ku theksoi se pyjet janë në administrim të AKP-së dhe mendon se duhet të jenë nën administrim të komunave. Parregullsitë, lidhur me pagesat direkte-subvencionet, buxheti për subvencione dhe transferime, realizohet për pagesat direkte dhe për grante. Lista për pagesa direkte për fermerë, bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHR), në kuadër të ministrisë. Pas kontrollit nga ministria (zyra e financave), lista miratohet dhe dërgohet për procedim (për pagesat e fermerëve), në Departamentin e Thesarit, në Ministrinë e Financave.

Nga procedimi i pagesave për kultura-perime, në fushë të hapur, 352 përfitues, ishte paguar nga dy herë, gabimisht. Vlera totale e mbipaguar gabimisht, ishte 247,047€. Mbi pagesat ishin si pasojë e gabimeve në thesar. Megjithatë, gjatë vitit 2015, pasi janë vërejtur këto gabime, ministria ka filluar korrigjimet në Departamentin e Thesarit, si dhe ka kërkuar kthimin e mjeteve

nga përfituesit. Mbipagesat janë kthyer nga thesari, edhe pse procesi i kthimit të mjeteve është përcjellë me gabime në shumat e tyre. Kjo krijon pasiguri në menaxhimin e pagesave për subvencionimin e fermerëve, në përgjithësi. Në rastin tjetër, gabimet gjatë procedimit të pagesave nga thesari janë vërejtur edhe te lista e proceduar për blegtori, që kishte 255 përfitues dhe është dashur të realizohet në shumën totale 165,993€. Megjithatë, nga transaksioni i ndodhur, e tërë shuma ishte transferuar gabimisht, vetëm dy përfituesve të parë në listë. Kjo është vërejtur nga MBPZHR dhe mjetet janë kthyer dhe korrigjuar nga thesari. Përveç çështjeve të mësipërme, ishin edhe 34 kërkesa - lista tjera për procedim të pagesave direkte, të realizuara gjatë vitit 2015. Listat e fermerëve me numër të llogarisë së përfitueseve, përgatiten nga AZHB. Testimet e auditorit kanë identifikuar se, në të gjitha listat e fermerëve, ka gabime për disa fermerë, sa i përket numrit të llogarisë së përfituesve. Kjo ka ndodhur si pasojë e kontrollit jo-adekuat, me rastin e përgatitjes së listave për pagesë nga AZHB. Gjatë përpunimit të informatave rreth kthimit të mjeteve, MBPZHR-ja ka hasur në vështirësi dhe pasiguri, për të identifikuar vlerën e saktë të mjeteve të mbipaguara dhe që do të duhej të ktheheshin nga përfituesit individualë. Nga Ministria e Financave (Departamenti i Thesarit), janë regjistruar kthimet për të njëjtin fermer nga dy, tre e katër herë, pa specifikuar nëse mjetet e tyre janë kthyer vetëm për shumën e pranuar si të dyfishtë apo si total. Po ashtu, ka raste kur prej të njëjtës listë për pagesë, për disa fermerë, është bërë riprocedimi, e për disa fermerë jo. Po ashtu, zyrtarët në komuna, të cilët punojnë në komuna në kompletim të dokumentacionit. Refuzimi i kërkesës për moskompletim të dokumentacionit, është i pabazë.

Abdyl Ymeri, theksoi se është e ditur se përgjegjësi e kujt është menaxhimi dhe mirëmbajtja e pyjeve dhe nën administrim të kujt janë pyjet, pra këto janë të caktuara në Ligjin për pyjet. Po ashtu, theksoi se formularët për dorëzim të aplikacioneve për pagesa direkte, duhet të thjeshtohen, në mënyrë që qytetarët të kenë më të lehtë t'i kuptojnë më mirë se çka kërkohet të dorëzohet, për të përfituar nga pagesat direkte të MBPZHR-së.

Kryetari, theksoi se kemi mbi 2130 aplikues, për të përfituar nga pagesa direkte dhe gati gjysma e tyre janë përjashtuar, për shkak të mos kompletimit të dokumentacionit të caktuar. Kështu, iu ka mohuar e drejta për t'i sjellë dokumentacionin shtesë. Çka ka bërë MBPZH-ja, që t'ju mundësojë të gjithë aplikantëve të jenë të barabartë në këtë drejtim? MBPZHR-ja ka ndarë mjete në emër të subvencioneve dhe granteve, gjithashtu një shumë relativisht të lartë, bazuar në mundësitë e buxhetit. Sa është niveli i kontrollit nga ana e MBPZHR-së, në eliminimin e keqpërdorimeve të mundshme në ndarjen e këtyre mjeteve?

Bali Muharremaj, pyeti lidhur me pagesat e dyfishta për përfituesit individualë nga ana e MF-së, përkatësisht Departamentit të Thesarit. Po ashtu, pyeti për nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve nga ana e MBPZHR-së. Në vazhdim, pyeti: Çfarë kontrolli ka vendosur MBPZHR, për të mos lejuar shpenzimet në kodet ekonomike të gabuara?

Naim Fetahu, theksoi se bazuar në të dhënat e cekura, në këtë raport vërehet se MBPZHR-ja ka pasur një progres në adresimin e çështjeve të vlerësuara jo mirë nga vitet e kaluara. Po ashtu, më gëzon fakti se nga viti në vit, MBPZHR-ja ka rritur shumën e mjeteve për përfituesit individualë për grante dhe subvencione. Pra, MBPZHR-ja raporton rregullisht për shpenzimet e automjeteve.

Synavere Rysha, theksoi se të gjeturat nga ky raport tregojnë se MBPZHR-ja ka ngecje në menaxhimin dhe kontrollin e brendshme financiar, përbrenda ministrisë. Të gjeturat e dhëna në këtë raport, tregojnë se nuk ka zbatim të rekomandimeve të dhëna, si nga auditori i jashtëm, po ashtu edhe nga ai i brendshëm. Kontratat në vepër, mbi 70 të punësuar, vazhdojnë nga viti në vit, përkundër asaj që ligji nuk e lejon një gjë të tillë.

Subvencionet dhe grantet për fermerë, në shumën mbi 50 milionë euro, ku këtu kemi pagesa të dyfishta, si dhe eliminimi i fermerëve qysh në fazën e dorëzimit të aplikacioneve, pa ndonjë arsytim të vlefshëm.

Hajdar Beqa, theksoi se Raporti i auditimit për MBPZHR-në, për vitin 2015, është një raport real, ka progres, krahasuar me vitin paraprak. Opinioni i auditimit është i pamodifikuar, me theksim të çështjes. Pyeti: A ka marrë ndonjë veprim ministri, në këtë drejtim për adresimin e këtyre çështjeve? Po ashtu, theksoi se nëse ka eliminim të aplikuesve, për shkak të poentimit jo të rregullt, mendoj se kjo duhet të adresohet në prokurori, sepse si e tillë, është vepër penale.

Memli Krasniqi, paraqiti opinionin e tij për Raportin e auditimit të PVF-ve, për vitin 2015. Opinioni i auditimit është jo i mirë, jo për fajin e Ministrisë së Bujqësisë. Pagesat e dyfishta, nga Ministria e Financave, si dhe vonesat në pagesa, për shkak të mungesës së fondeve. Po ashtu, ministri, në detaje u përgjigj në të gjitha pyetjet e deputetëve. Më konkretisht, arsyetimin e plotë e gjeni në incizim të këtij takimi.

Kryetari propozoi para deputetëve, që të nxirret një rekomandim për MBPZHR-në, me qëllim që ta obligojmë ministrin për marrjen e veprimeve të nevojshme për adresim të komandimeve.

Përfundim

KMFP, vendosi që të kërkojë nga MBPZHR, që të përgatisë planin e veprimit, duke caktuar personat përgjegjës dhe duke caktuar afatet kohore, për të gjitha rekomandimet e dala nga Raporti i auditimit për MBPZHR-në, për vitin 2015, si dhe me raport me shkrim, ta njoftojë KMFP-në.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Kryetari, sa i përket shqyrtimit të kësaj pike, theksoi se ministri i MPJ-së, disa herë është ftuar në mbledhje dhe nuk i është përgjigjur ftesës së Komisionit. Prandaj, ne do ta ftojmë prapë në takimin e radhës, për t'i dhënë rast edhe një herë, për të raportuar në Komision.

Përfundim

KMFP, vendosi që ta ftojë prapë ministrin e MPJ-së, në takimin e radhës të Komisionit.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015.

Kryetari, theksoi se opinioni i auditimit për PVF-të e MMPH-së, për vitin 2015, është opinion i pamodifikuar, me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes ka të bëjë me projektet kapitale të ndërtuara për të riatdhësuarit dhe projektet e bashkëfinancuara me komunat, nuk ishin tjetërsuar te përfituesit, por ato ishin regjistruar si pasuri e ministrisë. Derisa, obligimet e papaguara për shpronësime kanë arritur vlerën totale prej 146 milionë euro. Po ashtu, pyeti për ndërtimet pa leje, në dy raste, sipas Raportit të auditimit? Më pas, theksoi se për pjesë të veturave, ka pjesë të cekura që çmimi i tyre është shumë i ulët me kontratë, e që nuk mund të gjinden me këtë çmim në vlerën e tregut. Lidhur me këtë, hapi diskutimin.

Hajdar Beqa, theksoi se është një raport i hartuar mirë nga ZKA. Opinioni i auditimit për PVF-të e MMPH-së, për vitin 2015, është opinion i pamodifikuar, me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes ka të bëjë me projektet kapitale të ndërtuara për të riatdhësuarit dhe projektet e bashkëfinancuara me komunat, nuk ishin tjetërsuar te përfituesit, por ato ishin regjistruar si pasuri e ministrisë, ndërsa obligimet e papaguara për shpronësime kanë arritur vlerën totale. Ky obligim nuk varet vetëm nga MMPH-ja, por edhe nga Qeveria, në përgjithësi. Pyeti: Cilat masa i ka ndërmarrë MMPH-ja në adresimin e këtyre çështjeve? Po ashtu, buxheti është realizuar mbi 96%. A ka ndonjë veprim nga MNMPPH-ja në pagesën e shumës së shpronësimeve, përkundër asaj se ju jeni vetëm ekzekutues?

Bali Muharemaj, theksoi se ngecjet më të mëdha janë në fushën e prokurimit publik. Lidhur me këtë, pyeti se çfarë masash ka ndërmarrë MMPH-ja në përmirësimin e kësaj fushe?

Synvere Rysha, theksoi se numri i vogël i implementimit të rekomandimeve, pamundësia për t'i paguar borxhet e shpronësimit, dobësitë në procedurat e prokurimit, janë disa nga dobësitë e MMPH-së, të konstatuara nga Raporti i auditimit të PVF-ve, për vitin 2015. Cili është plani i MMPH-së për adresimin e këtyre të gjeturave?

Naim Fetahu, theksoi se të gjeturat e auditorit në PVF-të e MMPH-së, nuk janë vetëm të kësaj ministrie, por lidhet me dikasteret tjerë, si bie fjala shpenzimet për shpronësim. Meqenëse jemi në kohën kur në Kuvend është në shqyrtim, projektbuxheti i vitin 2017, dhe me këtë, ne mund të kërkojmë mjete shtesë për shumën e shpronësimeve. Kërkesa t'i drejtohet KBF-së, me një rekomandim nga KMFP.

Ferat Shala, ud. ministër në MMPH, arsyetoi Raportin e auditimit për MMPH-në për vitin 2015, si dhe u përgjigj, së bashku me stafin, në të gjitha pyetjet e deputetëve të pranishëm. Më konkretisht, ekziston incizimi i takimit.

Kryetari propozoi që të ketë rekomandime për MMPH-në, si dhe për KBF-në.

KMFP, vendosi që të kërkojë nga MMPH, që të përgatisë planin e veprimit, duke caktuar personat përgjegjës dhe duke caktuar afatet kohore, për të gjitha rekomandimet e dala nga Raporti i auditimit për MMPH-në, për vitin 2015, si dhe me raport me shkrim, ta njoftojë

KMFP-në. Po ashtu, KMFP vendosi t'i paraqesë një rekomandim KBF-së, për të ndarë mjete shtesë për MMPH-në, për pagesën e borxheve të papaguara nga shpronësimet.

5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale (AMKM), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Kryetari, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, ia dha fjalën raportuesit për këtë agjenci.

Hajdar Beqa, përmendi në pika të shkurtra, të gjeturat e Raportit të auditimit, për këtë agjenci, sfidat, me të cilat po përballet, për shkak të buxhetit të pakët dhe numrit të kufizuar të stafit, si dhe përmendi progresin e arritur nga AMKM, për vitin 2015.

Synavere Rysha, pyeti lidhur me auditimin e brendshëm: A ka AMKM-ja auditor të brendshëm dhe nëse jo, kush e kryen auditimin e brendshëm?

Naim Fetahu, theksoi se gjendja e komplekseve memoriale, nuk është e mirë. Po ashtu, pyeti se buxheti i vitit 2017, a është më i lartë, krahasuar me vitin paraprak?

Bali Muharemaj, pyeti: Në buxhetin e vitin 2017, a ka mjete të ndara për Kompleksin e Koshares?

Idriz Blakaj, arsyetoi Raportin e auditimit për AMKM-në, si dhe u përgjigj në pyetjet e deputetëve të pranishëm. Pati ankesa për buxhetin e pakët të ndarë, si dhe numri i kufizuar i stafit. Më konkretisht, të gjitha arsyetimet janë të ruajtura në incizim të këtij takimi.

Kryetari, pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar për këtë pikë, e mbylli diskutimin me këtë përfundim.

Përfundim

KMFP, vendosi që Raportin e auditimit për PVF- të e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale (AMKM), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të mos e adresojë për në seancë plenare, duke rekomanduar që t'i zbatojë në përpikëri rekomandimet e dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit, si dhe me një raport, ta njoftojë KMFP-në.

6. Të ndryshme

Faton Topalli, pasi që për këtë pikë nuk kishte diskutime, e mbylli takimin.

Takimi përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli